



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI**

**PROCESVERBAL<sup>1</sup>**

**(I përmbledhur)**

Tiranë, më 03.09.2019, ora 09.30

**Drejton mbledhjen**

**Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit**

**Rendi i Ditës :**

1. *Diskutimi dhe vendimmarrja në lidhje me rishikimin e vendimit nr. 116 datë 09.08.2019 “Për pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Presidentin e Republikës së Shqipërisë, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur me Dekretin nr. 10723 datë 07.02.2018 nga Presidenti i Republikës.*

2. *Diskutimi dhe vendimmarrja lidhur me vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës Zhaklina Peto për dy kandidimet e saj për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese*

**Marrin pjesë :**

- |                   |                     |
|-------------------|---------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar)           |
| 2. Vitore Tusha   | (zëvendës kryetare) |
| 3. Arta Marku     | (anëtare)           |
| 4. Fatri Islamaj  | (anëtar)            |
| 5. Fatjona Memçaj | (anëtare)           |
| 6. Eriol Roshi    | (anëtar)            |

<sup>1</sup> Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja “d”, neni232 pika 2, neni 242 shkronja “c”) dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plota të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

**Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :**

1. Enio Haxhimihali, përfaqësues i Avokatit të Popullit.

**Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr.115/2016:**

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.

### **HAPET MBLEDHJA**

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani**, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

**Ardian Dvorani** lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

*Diskutimi dhe vendimmarrja në lidhje me rishikimin e vendimit nr. 116 datë 09.08.2019 “Për pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Presidentin e Republikës së Shqipërisë, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur me Dekretin nr. 10723 datë 07.02.2018 nga Presidenti i Republikës.*

*Diskutimi dhe vendimmarrja lidhur me vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës Zhaklina Peto për dy kandidimet e saj për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese*

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

**Anëtarët e Këshillit** miratojnë rendin e ditës së programuar.

**Këshilli vijon mbledhjen** me pikën e parë të rendit të ditës.

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani** informon se në mbledhjen e fundit, ndër të tjera, është vendosur pezullimi e procedurës së verifikimit për vendin vakant, vakancë e parakohshme, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018. Gjatë muajit gusht ka pasur një numër ankimesh, 8 ankime nga 8 kandidatë, të cilat gjykata administrative e apelit i ka rrëzuar, përveç ankimeve të kandidatës Zhaklina Peto për dy vende vakante, të dyja vakancat e shpallura nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018. Me vendimin e saj, Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë ka vendosur të shfuqizojë vendimet nr.108 dhe nr.109 të KED për ndalimin e kandidimit të kandidatës Zhaklina Peto për të dyja këto vakanca të shpallura nga Presidenti i Republikës. Në këto dy vendime të gjykatës motivi në thelb i shfuqizimit është vlerësimi si shkelje e rëndë procedurale ai i mosnjoftimit të kandidatës në fund të procesit të verifikimit për ditën e zhvillimit të mbledhjes së KED për shqyrtimin e gjetjeve në procesin e verifikimit të kandidaturës së saj. Po kështu, përmendet në arsyetim edhe rrethana tjetër e procedimit që nuk e kemi thirrur ekspertin për t'i drejtuar pyetje, ku gjykata shprehet se KED mund ta thërriste ekspertin për t'i bërë pyetje. Ndërkohë KED është

njohur edhe me shkresën e Presidentit drejtuar Këshillit, lidhur me plotësimin e vendit vakant të shpallur me dekretin e tij nr.10723, datë 07.02.2018, ku tërhiqet vëmendja ose i sugjerohet KED të mbajë parasysh në vijimin e veprimtarisë së tij respektimin rigoroz të procedurave dhe të dispozitave të parashikuara në Kushtetutë dhe në Ligj edhe në kuadër të procesit dhe verifikimit dhe vleresimit të kandidaturave.

**Anëtarët e Këshillit** vijojnë me diskutimet lidhur me çështjen e rishikimit apo revokimit të vendimit nr. 116 datë 09.08.2019 të KED për pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe njoftimin e organit të emërtesës, Presidentit të republikës që të vlerësojë rishpalljen e vakancës së përkohshme, të shpallur në datën 07.02.2019, në kushtet kur Gjykata Administrative e Apelit ka shfuqizuar dy vendimet e KED për ndalimin e kandidimit të kandidatës Zhaklina Peto në këtë vend vakant, gjë që e rikthen në tre numrin e kandidaturave për këtë vakancë.

**Bledar Dervishaj** kërkon fjalën dhe parashtroon se jam shumë dakord që të vendoset revokimi apo shfuqizimi i vendimit nr. 116, është një term që mund ta çmojë Këshilli. Vijimi i procedurës për këtë vakancë po ashtu është korrekte. Ndoshta duhet që Këshilli të marrë një vendim edhe për vakancën tjetër, duke qenë se janë dy vendime që janë shfuqizuar, se edhe atje rifillon procesi i verifikimit. Duhet menduar edhe kjo. Sugjerimi tjetër është se është marrë një vendim që janë përfunduar procedura e verifikimit për vakancën e parë dhe ka filluar pikëzimi. Ndërkohë që edhe ai vendim është shfuqizuar nga Gjykata e Apelit Administrativ për kandidaten Zhaklina Peto, keshtu që Këshilli do të duhet të revokojë edhe atë vendim për ta rifutur ose rifilluar edhe atë vakancë. Po e sjell në rikujtesë. Edhe ky është një vendim i mëvetshëm revokimi pjesërisht. Ne kishim dy momente tek vakanca e përkohshme. Ose do ta rishpallnim dhe të njoftonim Këshillin se e rishpallëm. Ose do të thonim siç Këshilli shprehej që të vijoni me dy kandidatura. Ose do të veprohej siç ndodhi tani me dhënien e vendimit të gjykatës administrative.

**Anëtarët e Këshillit**, vijojnë me diskutimet dhe duke pasur parasysh që me vendime të formës së prerë të Gjykatës Administrative janë shfuqizuar vendimet nr. 108 dhe 109 të KED për ndalimin nga kandidimi të kandidatës Zhaklina Peto dhe, për rrjedhojë në vendin vakant, vakancë e përkohshme, e shpallur nga Presidenti i Republikës rikthehet në tre numri i kandidaturave, në mënyrë unanime vendosën të revokojnë vendimin e KED nr. 116 datë 09.08.2019 “Për pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Presidentin e Republikës së Shqipërisë, për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur me Dekretin nr. 10723 datë 07.02.2018 nga Presidenti i Republikës”.

Gjithashtu, **Anëtarët e Këshillit**, meqenëse kandidatja Zhaklina Peto është e kandiduar në dy vende vakante, vakancë e përkohshme dhe vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës

në datën 07.02.2019, edhe në kushtet kur, në lidhje me vakancën e plotë për të cilën ka filluar por ende nuk ka përfunduar procedura e vlerësimit ndërkohë që ligji përcakton se procedura e vlerësimit të kandidaturave nuk pezullohet nga ankimet e kandidatëve në gjykatë ndaj vendimit të ndalimit të kandidimit, në mënyrë unanime vendosën që të vijojë me përparësi kryerja e procedurave të verifikimit të kësaj kandidateje në lidhje me kandidimet e saj për të dy këto vende vakante.

**Anëtarët e Këshillit**, vijojnë me diskutimet në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me mënyrën se si do të procedohet në veprimet e mëtejshme të procedurës së verifikimit të kandidaturave të kandidates Zhaklina Peto, të cilat përfshijnë edhe pikën e dytë të rendit të ditës, duke pasur parasysh këtu edhe vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit, e cila, pavarësisht nga mënyra jo e qartë se si e arsyeton, konsideron problem mosthirrjen e ekspertit në mbledhjen e KED për të dhënë mendimin lidhur me ekspertimin e realizuar për këtë kandidate dhe shprehet se KED mund ta thërriste atë. Ndërkohë që Këshilli mban parasysh për këtë diskutim edhe se sipas ligjit dhe akteve normative të KED thirrja e ekspertit në mbledhje nuk është e detyrueshme dhe e gjithë procedura e lidhur me ekspertin dhe ekspertimin ka qenë e rregullt, madje e pakundërshtuar nga kandidatja, përkundrazi ka shprehur dakodësinë me shkrim për caktimin e ekspertit dhe deri në fund.

**Bledi Dervishaj** merr fjalën dhe parashtrohet se qoftë Presidenti, qoftë Avokati i Popullit kanë marrë pjesë në këtë gjykim, si persona të tretë. Përveç sa është zbardhur në vendimin gjyqësor aty është zhvilluar një debat i gjatë, gati 2 orë, midis paditësit, të paditurit, po edhe në personave të tretë për aq sa kemi shprehur vullnetin tonë aty. Unë mendoj që Këshilli duhet të jetë shumë i kujdesshëm edhe me kryerjen e veprimeve procedurale në këtë proces, që të mos japi idenë që po përmbushim këto vetëm dy mangësi që ka konstatuar gjykata se bindja kryesisht do të jetë e njëjtë. Ka thënë gjykata që ekspertin ta thërrasim. Ndoshta nga thirrja e ekspertit kanë ardhur edhe pyetje të tjera shtesë që edhe vetë eksperti nuk i jep dot drejtim apo do të duhet që organi e ka prodhuar gjëndjen, flas ILDKPI-ja, sepse Këshilli aty është bazuar, të vlerësojë ato prova që nuk i ka patur në dispozicion ose nuk i ka çmuar të nevojshme për t'i vlerësuar në mënyrë të thelluar. Mund të lindi, gjithmonë mund të lindi pas thirrjes së ekspertit, nuk e di. Prandaj në letrën tonë në kemi sugjeruar vlerësim të krahasuar të provave të organit që ka diktuar gjëndjen me gjetjet, të ekspertit që ballafaqon një realitet të kundërt dhe të Këshillit që ka mbajtur një qëndrim të tillë që sipas gjykatës janë vendime absolutisht të pavlefshme, pra nuk qëndrojnë si vlerësime përsa i takon themelit. Në këtë prizëm duhet që Këshilli të ketë shumë kujdes. Prandaj qasja jonë në atë letër është edhe pak e gjatë në dukje, por duhet të ofrojë garanci edhe për kandidatin, edhe besim tek ai se do të shqyrtohet në mënyrë objektive edhe kësaj here lidhur me pretendimet që ka pasur gjatë procesit gjyqësor.

**Enio Haxhimihali**, gjatë diskutimeve të anëtarëve të Këshillit, duke marrë fjalën, parashtrohet se në lidhje me ILDKPKI, edhe në rastin e kandidates Eris Hysi ajo pikërisht ngriti dhe pretendimet e

saj. Pra në një procedure normale ILDKPI-ja njihet me përfundimet. Ndërkohë në asnjë verifikim të kandidatëve që ILDKPI-ja ka sjellë procedurat, i heq të drejtën kandidatit në njëfarë mënyre për të dhënë shpjegimet e tij pranë ILDKPI-së. Pra po themi nga ana materiale ILDKPI-ja mund të ketë bërë një gabim të cilin kandidati e konstaton dhe ka të drejtën që, atë që në procedurën normale e bëjmë edhe ne të gjithë kur deklarojmë, të japë shpjegime ILDKPI-së për gjetjen që ka bërë ILDKPI-ja. Ndërsa në rastin konkret këtu ka një procedurë disi të veçantë. Pra nuk është ligji organik që rregullon punët ILDKPI-së. ILDKPI-ja direkt ia përcjell gjetjen e saj KED-së, e cila ia përcjell kandidatit. Pra kandidati nuk ka më mundësi t'i japi shpjegime ILDKPI-së, por ia jep drejtpërdrejtë KED-së. Dhe këtu mund të ishte rasti, po të shohim dhe ligjin organik, brenda një afati të caktuar ILDKPI-ja duhet të marrë përgjigjet e kandidatit, por kjo bie ndesh me afatet që ka KED-ja, prandaj KED-ja ka zgjedhur që të mos ia rikthejë. Por ne nuk mendojmë se është shkelje ligjore nëse pretendimet e kandidatit ti riktheheshin ILDKPI-së.

Për çështjen e ekspertit, meqënëse ne kemi folur dhe në mbledhje dhe seancë gjyqësore, rekomandojmë që të respektohet ajo çfarë parashikon rregullorja nr.4. Pra mënyra e thirrjes së ekspertit, bërjen e betimit, dhënien e pyetjeve paraprake. Kemi vetëm një seancë për çdo mbledhje. Nëse nga Këshilli do të vendoset të thirret eksperti, ne do të rekomandojmë të respektojnë atë cka vetë Këshilli ka miratuar në vendimet e mëparshme.

Sipas konstatimit tonë procedura nuk ishte e rregullt. Ne nuk po diskutojmë, as gjykata, as ne, për pjesët materiale të akt ekspertimit. Ne po diskutojmë për procedurën. Avokati i Popullit, qoftë në mbledhje, qofte në seancë është shprehur për procedurat e ekspertit. Momenti i parë i thirrjes, momenti i prezantimit të raportit. Pra ne merremi vetëm me procedurën, nuk merremi me përmbajtjen e akt ekspertimit. Pikërisht në këtë procedurë ne kemi thënë së pari në momentin që është caktuar eksperti ka qenë në seance pa u bërë relacion madje një nga anëtarët ka thënë mos duhet bërë relacioni njëherë, pastaj ne të vendosim duhet apo nuk duhet eksperti. Në momentin që ne na është bërë e ditur rendi dites për ekspertin nuk ka pasur relacion për arsyet e caktimit të ekspertit. Ne jemi njohur me vonë me dokumentat, kemi parë që dy relatorët paskan bërë një akt. Përsëris pak se çfarë ne rekomanduam në mbledhje, në seancë gjyqësore edhe këtu. Pra ne rekomandojmë të zbatohet vendimi nr. 4 për procedurat e thirrjes së ekspertit, ku është parashikuar dhe procedura, si thirret, kush janë pyetjet, kush i merr vendimet.

Ideja e Avokates së Popullit në seancë ka qenë se ILDKP-ja kthen përgjigje negative për 11 kandidatë Nëse ju kujtohet e kemi diskutuar dhe në mbledhje për mënyrën e veprimit se si do të procedohet më pas me vlerësimet po i quaj negative të ILDKP-se për 11 kandidatë. Vetëm për një kandidate është caktuar ekspert. Pikërisht për këtë gjë Avokatja thotë se si do ta unifikojë procedurën KED-ja për rastet kur është kthyer përgjigje negative nga ILDKP-ja. Por jo vetëm kur është negative,

edhe kur është pozitive, KED –ja sërish e ka të drejte. Peër analogji dhe organet e vetingut dhe në rastet kur ILDKP-ja ka dhënë mendim pozitiv, ka pas raste që nuk kane marre parasysh raportin e ILDKPI-se por kane vlerësuar të kundërtën. Ky është po themi, pyetja që ne kemi bërë apo rekomandimi se si do te veprohet në të tilla raste.

Në relacionin që u bë për caktimin e ekspertit thuhet se KED-ja ka diskutuar për t'iu drejtuar organeve të vetingut për të caktuar eksperte të tjerë dhe ata nuk e kanë patur mundësi për ta plotësuar një kërkesë të tillë. Pastaj është menduar dhe kaluar në marrjen e eksperteve privat konform procedurave sigurisht, siç parashikon legjislacioni për mënyrën e caktimit një eksperti privat. Duke qenë se është rast pas rasti dhe duke qenë se ky ishte rasti i parë dhe i vetmi që ne percaktojmë një ekspert, pikërisht ne prandaj ngritëm këto çështje për diskutim.

Të pesë kandidatët, në të gjitha proceset gjyqësore, një nga problematikat që ngritën ishte afati shumë i shkurtër. Pra caktimi sot për nesër i vë në një pamundësi fizike dhe pretendonin që kanë patur me pak se 12 orë kohë për të dhënë shpjegime për relacione etj. Mos ndoshta koha për të bërë pyetje ekspertit nga kandidati është shumë i shkurtër sot për nesër. Tani ora është 12.00 sa të njoftohet, sa të përgatitet, sa të bëhet, mos është më mirë të jetë pak kohë?

**Anëtarët e Këshillit**, në përfundim të diskutimit të çështjeve që lidhen me arsyetimin që përmban vendimi i gjykatës administrative të apelit për sa i përket mundësisë së thirrjes së ekspertit në mbledhjen e KED, duke u njohur edhe me pretendimet dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit, si edhe qëndrimin e përfaqësuesit të Presidentit në lidhje me ekspertimin e realizuar në rastin e gjetjve mbi pasurinë e kandidatës Zhaklina Peto, në thelb kanë qëndrimin se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit, pavarësisht nga mënyra jo e qartë se si e arsyeton, konsideron problem mosthirrjen e ekspertit në mbledhjen e KED për të dhënë mendimin lidhur me ekspertimin e realizuar për këtë kandidate dhe shprehet se KED mund ta thërriste atë. Ndërkohë që Këshilli mban parasysh se edhe sipas ligjit dhe akteve normative të KED ,thirrja e ekspertit në mbledhje nuk është e detyrueshme, e gjithë procedura e lidhur me ekspertin dhe ekspertimin ka qenë e rregullt, madje e pakundërshtuar nga kandidatja, e cila, përkundrazi, ka shprehur dakordësinë me shkrim, lidhur me caktimin e ekspertit dhe deri në fund, duke u njohur dhe shprehur dakordësinë e plotë me mendimet e dhëna nga eksperti. Po ashtu, Këshilli mban parasysh edhe se janë kryer të gjitha procedurat e rregullta për ekspertimin, përfshirë ato të akteve mbi nevojën për të kryer veprimin e ekspertimit, përzgjedhjen ekspertit, betimin e tij, caktimin e detyrave, njoftimin e kandidatës për këto veprime, paraqitjen e mendimit me shkrim të ekspertit, njohjen rregullisht të kandidatës me këtë mendim të ekspertit, e cila e ka shprehur qartë me shkrim edhe qëndrimin e saj se ishte dakord me gjetjet dhe përfundimet e ekspertit. Gjithashtu, ligji nuk krijon asnjë mundësi që KED të rikthejë për shqyrtim rastet e verifikimit të pasurisë në ILDKPKI dhe as ti kërkojë këtij institucioni të rikonsiderojë

pjesërisht gjetjet e tij sipas fakteve, rrethanave dhe zhvillimeve të ndodhura pas dërgimit të Raportit të tyre të kontrollit në KED.

**Anëtarët e Këshillit** kanë qëndrimin se, as në vendimin e gjykatës dhe as nga ana e kandidatës nuk janë ngritur pretendime për përmbajtjen e mendimit të dhënë nga eksperti, gjykata nuk ka pranuar asnjë lloj pretendimi tjetër të çdo natyre për shkelje procedurale në procedurën e kryerjes së ekspertimit apo edhe për procedurën e verifikimit në tërësi, duke mbetur vetëm me konstatimin se eksperti mund të thirrej në mbledhjen e KED për ta paraqitur aktin, si edhe për atë që ajo gjykatë e quan shkelje të rëndë procedurale që nuk i është bërë me dije kandidatës relacioni përfundimtar përpara shqyrtimit të rastit në mbledhjen e KED.

**Anëtarët e Këshillit**, gjithsesi, kanë qëndrimin se formalisht do të ndjekin orientimin e dhënë nga gjykata administrative e apelit për ta thirrur dhe dëgjuar ekspertin në mbledhjen e Këshillit, ndonëse nuk mund të mos kenë ndonjë pyetje shtesë për ti parashtruar atij. Me këtë rast, ndonëse ka shprehur dakordësinë e plotë me aktin e ekspertimit, kandidatës do të kërkohet të paraqesë pyetje apo shpjegime të tjera, nëse ka, në drejtim të ekspertit. Edhe Avokati i Popullit, nisur nga pozicionet që ka mbajtur, e ka mundësinë të sjellë pyetje për ekspertin.

Prandaj, **anëtarët e Këshillit**, në mënyrë unanime, vendosën të thërrasin në mbledhjen e radhës ekspertin e caktuar për procedurën e verifikimit të pasurisë së kandidatës Zhaklina Peto, sipas orientimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, për të zhvilluar një seancë me pyetje dhe sqarime drejtuar ekspertit lidhur me mendimet e dhëna në aktin e ekspertimit. Pas kësaj mbledhjeje, Këshilli do të vlerësojë për ecurinë e mëtejshme të procedurës së verifikimit, duke pasqyruar edhe reflektimin në aktet e tij të procedurave gjyqësore për shqyrtimin e ankimit të kësaj kandidateje dhe eventualisht ato të seancës që do të zhvillohet me praninë e ekspertit.

**Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani**, pasi merr mendimin e anëtarëve për rendin e ditës dhe kohën e mbledhjes së ardhshme, duke u përcaktuar zhvillimi i saj në datën 04.09.2019, në orën 14.00, në thelb, me rend dite seancën me *pyetje dhe sqarime drejtuar ekspertit, për mendimet që ka dhënë në aktin e ekspertimit në rastin e verifikimit të pasurisë për kandidaten Zhaklina Peto*, deklaroi mbylljen e mbledhjes.

## **MBLEDHJA MBYLLET NË ORËN 11.10**

**Sekretare**

**Redjona MYRTJA**

**Ermelinda KADIU**

**Dorina DULAJ**

**Kryetari**

**Ardian DVORANI**